



Majlinda Kelmendi

A është e shkuara ëndërr?

Is the past a dream?



Majlinda Kelmendi

**A është e shkuara ëndërr?
Is the past a dream?**



Majlinda Kelmendi

A është e shkuara ëndërr? / Is the past a dream?

Kuruar nga / Curated by:
Edison Çeraj dhe B17 Architects

5 Mars — 5 Prill 2019

Katalogu - Catalogue:

Botues – Publisher:

Galeria Kombëtare e Kosovës
National Gallery of Kosovo

Tekstet / Text:
Edison Çeraj, B17 Architects, Majlinda Kelmendi

Fotografitë / Images:
Enver Bylykbashi

Përkthimi dhe lektura / Translation and proofreading:
Jehona Xhaferi

Dizajni / Design:
Trembelat

Shtypi / Print
VIPRINT

Viti / Year: 2019

Ekspozita dhe katalogu janë realizuar me mbështetje nga Ministria e Kulturës,
Rinisë dhe Sporteve / The Exhibition And Catalogue Are Supported by the
Ministry of Culture, Youth and Sports:



Sponzorë Medial / Media Sponsors:



Stafi i Galerisë Kombëtare të Kosovës- National Gallery of Kosovo staff:
Arta Agani, Drejtoreshë -Director; Zeni Ballazhi, Kurator-Curator; Mexhide
Maxhuni, Zyrtare për financa -Finance officer; Lirije Buliqi, Zyrtare e lartë
administrative -Senior administrative officer; Naim Spahiu, Koordinator për
ekspozita -Coordinator for exhibitions; Enver Bylykbashi, Fotograf profesional
-Professional photographer; Engjëll Berisha, Koordinator për bashkëpunim
ndërkombëtar dhe MR/ coordinator for internationalcooperation and PR; Skender
Xhukolli, Teknik për ekspozita -Exhibition technician; Rrahman Bislmi, Teknik për
ekspozita/Mirëmbajtës i objektit -Exhibition technician /Building caretaker;
Xhevat Rrahimi, Kujdestar i sallës ekspozuese -Exhibition hall attendant;
Valdet Sylja & Mentor Abdullahu, roje nate -security guards

A është e shkuara ëndërr? Simbolikë kryqëzuese ..

— Majlinda Kelmendi

Pa ndërgjegjen nuk do ekzistonim.

Mbi të gjitha jeta është një luftë e vërtetë për të tejkaluar përballuar situata të ndryshme dhe falë tyre ne krijojmë identitetin tonë, ne kulmin e zinxhirit ushqyes. Vetpërqëndrimi është një produkt përcaktues i karakterit të punës së artistit. Lindim të ndryshëm.

Vetbesimi është destinacioni që nuk mund t'i shmangemi, arsye e cila transformon personalitetin tonë në një luftë të vazhdueshme me pengesa.

Quhet e rëndësishme që të clirohemi nga modele të tiposura që na shterojnë atë çfarë kemi të veçantë prej një projektimi inteligjent...”

Përbërja e këtij subjekti është i thyer i analizuar dhe i rimontuar, duke afruar kohërat e largëta për të na bërë të kuptojmë dhe të mbajmë pranë qindra rrugë të ndryshme të mendjes të arsyetuara me pretendimin dhe nevojat që përgjithmonë të kërkojmë rrugë të reja.

Lidhja e emocionit me rregullin, duke mbledhur leksionet e mëdha të së kaluarës, është brenda vetvetes simbolike kryqëzuese

Is the past a dream? Crossed symbolic..

— Majlinda Kelmendi

Without the conscience we wouldn't exist.

Above all, life is a real struggle of overcoming different situations, and thanks to them we create our identity on the top of the food chain. Self-focus is a determining product of the character in the work of an artist.

We are all born different.

Self-confidence is the destination we can't avoid, a reason that transforms our personality into a continuous struggle with many obstacles on the way.

It is important to free ourselves of the most typical models that deplete us of the specific from an intelligent projection ..."

The composition of this subject has been broken, analyzed and remodeled, by bringing closer past times that will make us understand and hold close to hundreds of different ways of thinking, reasoned with the need to constantly seek new ways.

The link between emotion and rule, by gathering the big lessons from the past, is within itself a crossed symbolic.

Cili është ndryshimi mes të shkuarës dhe ëndrrave?

— Edison Çeraj

...ku është dëshmitari?
Sepse unë s'kuptoj
ku ndryshon realiteti nga mashtrimi.
Tomas Venclova

*Bota nuk ka
nevojë për
atë artist që e
paraqet realitetin
siç është.*
Marina Abramović

Kjo është një nga ato pyetje që në thelb nuk ka nevojë për përgjigje, pasi të gjithë e dinë, ose të gjithë e kanë “të qartë” brenda vetes. Gjithsesi nuk është as një pyetje thjesht retorike. Pyetje të kësaj natyre i ngjajnë asaj dilemës mbi kohën që trajton Shën Agustini, ku thotë se nëse nuk më pyesni se ç’është koha, e di përgjigjen; por, nëse më pyesni, atëherë nuk e di.

Megjithëse është një dilemë që i referohet qartazi përvojës së secilit nga ne (e shkuara dhe ëndrrat), është po aq e qartë se përvoja nuk na vyen, ose nuk është e mjaftueshme për të zgjidhur “enigmën”.

Le të bëjmë një ndarje ndërmjet të shkuarës në rrafsh individual (kujtimet) dhe të shkuarës në rrafsh shoqëror (historia). Për sa i takon të shkuarës individuale, kur ajo bëhet e tillë, ne nuk e ndryshojmë dot: as nuk mund t’i heqim e as nuk mund t’i shtojmë gjë. E njëjta gjë vlen edhe për ëndrrat.

Ndërsa e shkuara në rrafsh shoqëror, me të cilën merret historia, natyrisht që është e ekspozuar ndaj ndryshimeve, gjë që është provuar e vazhdon të provohet në qindra raste, për shkak të pushtetit të pamatë që ajo ushtron. “Ai që kontrollon të shkuarën, kontrollon të ardhmen. Ai që kontrollon të tashmen, kontrollon të shkuarën.” (Orwell)

Ndaj dhe thuhet se historinë e bën fituesi. Një rast tipik për këtë është historiografia komuniste, që është fund e krye ideologjike, dhe duke qenë e tillë niset nga premisa se faktet historike duhet të jenë në përputhje me ideologjinë, përndry-

she janë të padobishme, madje të rrezikshme. Ja pse kemi fabrikime të llojit “historia zyrtare”, e këtij apo e atij vendi.

Pikërisht për këtë arsye, në ato vende ku ka vepruar një ideologji e tillë, janë të rëndësishme kujtimet/memuaret vetjake¹, duke shënuar kështu një ndryshim të qenësishëm ndërmjet historisë dhe kujtesës. Historia mund të jetë dhe “duhet” të jetë kolektive/shoqërore, ndërsa kujtesa mund të jetë e tillë vetëm për aq sa është individuale.

I tillë është rasti edhe me veprat e fundit të Majlinda Kelmendit: ajo mjaftohet duke gjurmuar kujtesën vetjake, duke tejkaluar kështu historinë zyrtare, atë që është certifikuar nga institucionet.

Për Kelmendin të kujtuarit dhe të ëndërruarit janë dy gjendje të lidhura ngusht me njëra-tjetrën. Sidomos në rastin e pikturave, të cilat nuk mund t’i klasifikojmë si abstrakte apo si jofigurative, akti i të kujtuarit sublimohet me disa shenja që pluskojnë ndërmjet të vetëdijshmes dhe të pavetëdijshmes. Kur autorja e çon deri “në fund” aktin piktorik mbi një shenjë të caktuar, atëherë kemi të bëjmë me një lloj vetëdijeje; ndërsa kur mjaftohet me pak prekje, kur ngurron ta identifikojë, atëherë shfaqet e pavetëdijshmja me stolitë e saj të errëta, mbi të cilat mund të hedhë dritë vetëm e ardhmja.

Nga ana tjetër, te këto piktura hasim edhe një marrëdhënie intensive ndërmjet ndjenjës dhe mendimit, ku ndjenja ngacmon mendimin dhe mendimi nuk e përjashton ndjenjën. Është një harmoni e fshehur “mes rreshtave”, e cila i përshkon si një fllad temjani të gjitha veprat e këtij cikli.

“Bota është një komedi për ata që mendojnë dhe një tragjedi për ata që ndiejnë,” thoshte Horace Walpole – domethënë: bota na qenka një dramë, duke qenë se nuk ka njeri në botë që vetëm mendon apo vetëm ndien, por herë

¹ Në të gjitha vendet me një të kaluar totalitare, ka një “bum” të madh botimesh me natyrë memuaristike, dhe një prej arsyeve të këtij fenomeni është edhe nevoja e ethshme e shumë njerëzve për t’i rrëfyer gjërat “siç kanë qenë”, dhe jo sipas “versionit zyrtar”.

i jepet njëres gjendje e herë tjetrës. Në thelb kjo ndodh pa vullnetin tonë: thjesht jepemi pas njëres ose pas tjetrës. Ashtu siç nuk zgjedhim se çfarë kujtojmë e çfarë harrojmë, po ashtu nuk zgjedhim se kur do mendojmë e kur do ndiejmë. E gjitha rrjedh. Vetëm rrjedh. Ne dorëzohemi. Pastaj ngrihemi. Më pas zgjedhim. Pastaj harrohemi. Më pas kujtohemi, me shpresën që të mos jetë vonë. Edhe kur është vonë, ka gjithmonë një xhep kohë për të bërë atë që duhet. Është ai xhep kohë që të rikthen të gjithë “kohën e humbur”.

Kelmendi e kërkon me ngulm këtë “kohë të humbur”, atë kohë të ndaluar ku lejohej vetëm ajo që diktonte “vija e partisë”. Ajo kërkon gjurmët e saj të humbura në atë periudhë, si dhe gjurmët e asaj periudhe në të tashmen e saj, në atë çfarë ajo është sot jo vetëm si artiste, por mbi të gjitha si njeri. Këtë kërkim e ndeshim edhe te dy video-instalacionet: Error dhe www.info.com, ku i pari na kujton se ka një error të përjetshëm që vjen si diktat drejt nesh, duke u shfaqur në forma të ndryshme, ama me të njëjtin thelb: për të na “korrigjuar”. Ndërsa i dyti, me një titull që evokon disa simbole tipike të kësaj kohe, qendëron raportin tonë me të dhënat/informacionin, ku nën tryshninë për të qenë të informuar, pa e vënë re aspak ne kemi cenuar ndjeshëm raportin tonë me mendimin dhe sidomos me kujtesën.

Për t’u rikthyer te marrëdhënia mes ndenjës dhe mendimit, duhet thënë se ne përballemi çdo ditë me optimizmin e pakompromis të progresistëve dhe me pesimizmin e mistikëve. Të parët e mbajnë shikimin poshtë, të dytët lart. Të parët duan të arratisen nga e shkuara, madje edhe nga e tashmja, të dytët gjakojnë të arratisen nga një e ardhme që konceptohet si një “jetë pa dhimbje”.

Disa shpallin fundin e botës, disa të tjerë trumbetojnë “rendin e ri”.

Ngjan sikur ngushëllimi më i madh është se asgjë nuk është e sigurt, se asgjë nuk mund të pohohet apo të mohohet me siguri të plotë. Kjo lloj pasigurie, që përputhet me

natyrën e pamundur dhe të papërsosur të qenies-në-botë, ka të mirat e veta, sepse na mban zgjuar, si një antidot kundër shkujdesjes apo kllapisë. Një e mirë tjetër është se na bën më kërkues, duke u maturuar kështu kundrejt çdo rrethane që na prek drejtpërdrejtë apo tërthorazi. Po ashtu, ndonëse në pamje të parë pasiguria shfaqet si e kundërta e bindjes, në fakt, ajo mund ta forcojë një bindje të caktuar përmes “krizës” që të shkakton, ose mund të nxjerrë në pah pavërtetësinë e saj.

Nevoja organike se si të jetojmë sendërtton një marrëdhënie të mirë me harresën; kurse nevoja e ontologjike se pse jetojmë bën po të njëjtën gjë me kujtesën. Por, kjo është e mundur vetëm nëse mes këtyre dy nevoja themelore – që shfaqen në mijëra forma – ekziston një lloj harmonie/ekuilibri, sepse në të kundërt ka vetëm teprim, herë me njërën e herë me tjetrën.

Jo vetëm në botën e artit, por edhe në jetë qëllon të përballemi me personazhe “të lumtur” për shkak të harresës ose “të pikëlluar” për shkak të kujtesës.

Majlinda nuk i rikthehet të shkuarës ngaqë është e magjepsur prej saj, as për t’u arratisur prej të tashmes, por, mbi të gjitha, për të njohur veten dhe për të kuptuar kohën në të cilën jeton. Arti është një mundësi e llojit të vet për ta bërë këtë.

Kështu, kjo përpjekje nga ana e saj na kujton se njeriu mbetet ajo çfarë ndien dhe mendon, pasi realizimi praktik i një ndjenje apo mendimi është gjithnjë i mangët si pasojë e kufizimit në kohë dhe hapësirë.

What is the difference between the past and the dreams?

— Edison Çeraj

The world does not need an artist who presents the reality as it is.

Marina Abramović

... where is the witness?
Because I don't understand
where reality differs from deception.
(Tomas Venclova)

This is one of those questions that essentially does not need answers, as everyone knows it, or it is “clear” within them. However, it is not even a simple rhetorical question. Questions of this nature resemble that dilemma about time that St. Augustine addresses, where he says that if you don't ask me what is time, I know the answer; but if you do, then I don't know it.

Although it is a dilemma that clearly refers to the experience of each of us (past and dreams), it is just as clear that we don't need the experience, or it is not enough to solve the “puzzle.”

Let us make a distinction between the past on individual level (memories) and on social level (history). As far as the individual past is concerned, when it becomes real, we cannot change it; we can neither remove anything nor add to it. The same goes for dreams.

Whilst the past on social levels that history deals with is naturally exposed to changes, it was proven and continues to be proved in hundreds of cases due to the immense power it exercises. “He who controls the past controls the future; and he who controls the present controls the past.”(Orwell).

Thus it is said that the winner writes the history. A typical case for this is the communist historiography, which is completely ideological, and as such it says that historical

facts must be in line with the ideology, otherwise they are useless, even dangerous. That's why we have fabrications of the kind "the official story" of this or that country.

That is why, in places where such an ideology has taken place, personal memories are important¹, thus marking an essential difference between history and memory. History can and should "be" collective / social, while memory can only be individual.

Such is the case with the latest works by Majlinda Kelmendi: for her it is sufficient to trace her personal memory, by overcoming in this way the official history, the one that was certified by the institutions.

Në të gjitha vendet me një të kaluar totalitare, ka një "bum" të madh botimesh me natyrë memuaristike, dhe një prej arsyeve të këtij fenomeni është edhe nevoja e ethshme e shumë njerëzve për t'i rrëfyer gjërat "siç kanë qenë", dhe jo sipas "versionit zyrtar".

For Kelmendi, remembering and dreaming are two things that are closely related to one another. Especially in her paintings, which we cannot classify as abstract or non-figurative, the act of memory sublimates with signs that float between consciousness and the unconscious. When the author takes the "act of painting" to a certain sign in the end, then we have some kind of consciousness; while when it is less touchy and it hesitates to identify it, then the unconsciousness takes over with its dark ornaments on which only the future can shed light.

On the other hand, in these paintings we encounter an intense relationship between feelings and thoughts, where the feeling is disturbed by thought and thought doesn't rule out the feeling. It is a hidden harmony "between lines", which

¹ There is a huge "boom" of memoir publications in all countries with a totalitarian past, and one of the reasons for this phenomenon is the need of most people to tell the stories "as they were" rather than according to the "official version"

describes a fresh incense of all the works in this cycle.

“The world is a comedy for those who think and a tragedy for those who feel,” said Horace Walpole - so: the world is a drama, as there is no one in the world who just thinks or just feels but always does one or the other. Essentially, this happens without our will: we just give in to one or the other. Just as we do not choose what we remember and what we forget, we also don't choose when to think and when to feel. It all flows. Just flows. We surrender. Then we get up. Then we choose. Then we forget. Then we remember, hoping it will not be too late. Even when it is too late, there is always a time pocket to do what it takes. It's that time pocket that restores all the “lost time”

Kelmendi seeks this “lost time”, the forbidden time that allowed only what was dictated by the “party line”. She requires her lost traces in that period, as well as the traces of that time in the present, in what she is today not only as an artist, but above all as a human. We encounter this search in both of her video installations: *Error* and *www.info.com*, where the first one reminds us that there is an eternal error coming as a command towards us, appearing in different forms, but with the same essence to “correct” us. The second one, with a title that evokes some of the typical symbols of this time, focuses our relationship with the data / information, where under the pressure to be informed, without noticing at all that we have significantly violated our opinion, and especially our memory.

To return to the relationship between feelings and thought, we must say that we face each day with the unpromising optimism of the progressives and the pessimism of the mystics. The first ones look down, and the second ones look up. The first want to escape from the past, or even from the present, the latter are trying hard to flee from a future that is conceived as a “painless life”.

Some declare the end of the world, while others trum-

pet the “new order”.

It seems as if the greatest comfort is that nothing is safe, that nothing can be affirmed or denied with complete certainty. This kind of insecurity, consistent with the impossible and imperfect nature of a human being in the world, has its own benefits, because it keeps us awake, as an antidote against carelessness or delirium. Another good thing is that it makes us more demanding, thus maturing against any circumstance that directly or indirectly affects us. Likewise, although in the first instance uncertainty appears as the opposite of obedience, in fact, it can strengthen a certain conviction through the “crisis” that it causes, or it may highlight its falsehood.

The need to live builds a good relationship with forgetfulness; while the ontological need for which we live does the same thing with the memory. But this is only possible if there is some kind of harmony/equilibrium between these two basic needs - manifested in thousands of different forms - otherwise there would be an excess of one or another in any giving time.

Not only in the art world, but also in life we are faced with “happy” characters because of their forgetfulness or “sad ones” because of their memory.

Majlinda does not return to her past because she is fascinated by it, nor to escape from the present, but above all, to know herself and to understand the time she lives in. Art is an opportunity of its kind to do so.

This effort of hers reminds us that a person remains what he feels and thinks, as the practical realization of a feeling or thought is always deficient as a result of constraints of time and space.




Hapësira

A është e shkuara ëndërr?

— B17 architects

Ndërhyrjet në hapësirën e galerisë për tu kthyer në trajtë homogjene janë realizuar duke pasur parasysh se objekti i Galerisë Kombëtare të Kosovës është në listën e objekteve të trashëgimisë. Hapësira është e konceptuar në mënyrë morfologjike për të lejuar integrimin e strukturës me veprën, në mënyrë që të përjetohej në tërësi. Qëllimi i projektit është të ofrohet ekspozim i hapur që të mund të pasqyrohet raporti midis audiencës dhe veprave të artistes Majlinda Kelmendi. Në hapësirën e galerisë është intervenuar në muret anësore për të eliminuar këndet që krijojnë hije, po ashtu për të adaptuar hapësirën për veprat me përmasa jo të zakonshme. Intervenimi në këto mure thekson lartësinë e hapësirës dhe ndihmon ndriçimin ekzistues të përçojë dritë direkte në muret anësore. Intervenimet në dyshtemenë e galerisë janë realizuar me mvëshjen e sipërfaqes ekzistuese me një shtresë të bardhë pa shkëlqim, si rrjedhojë të shkrirjes kufirit midis murit dhe dyshtemesë.

Gjatë ecjes në hapësirën e brendshme përjeton pastërtinë e të bardhës dhe ndërhyrjen me dy sipërfaqe të zeza dhe një të kuqe përmbyllëse të projektit, a është e shkuara ëndërr? të Majlinda Kelmendit. Hapësira tashmë e një trajtshme, përjetimin e veprave e kthenë në eksperiencë për përjetuesin.






Space

Is the past a dream?

— B17 architects

The design for the exhibition “Is the past a dream?” is based on shaping a homogeneous space, meanwhile conducting this concept by having in consideration that the building of the Kosovo National Gallery is listed for heritage preservation. Therefor space is morphologically conceived to allow integration within structure and artist`s work, as result of experiencing the exhibition as total. And thus this project offers an open exposure so that the connection between audience and artist Majlinda Kelmendis work is reflected. The interventions at the gallery start with eliminating the corners of main walls therefor eliminating shadow, this also helps to highlight space height by conveying direct light to the side walls and using existing light fixtures. This is also a response to adapt space for exhibiting the new art works with unusual dimensions. Interventions on the gallery floor have been conducted by covering the existing floor with a layer of white non glossy sheet, the combination of these vertical and horizontal surfaces blurs borders between wall and floor.

While walking through the gallery you experience the purity of whiteness and the interference of two black surfaces and a red surface which is a closing one of the project, is the past a dream? By Majlinda Kelmendi. The homogeneous space, turns the gallery into an intriguing path in which the visitor connect with the works.




ERROR

Zhvillimi i teknologjisë përfshin komunikimin dhe veprimin me individë ose grupe enigmatike. Ky problem i kohës ngre pyetje ose diskutim rreth ndërgjegjësimit.

Technology development entails communication and action with individuals or enigmatic groups. This problem of time raises questions or discussion about awareness.

Video Art








Error
2018
Video Art





A është e shkuara ëndërr? /

Is the Past a Dream?


2018


Akril në pëlhurë / Acrylic on canvas

210 cm x 210 cm












A është e shkuara ëndërr? /


Is the Past a Dream?

2018


7X20 cm x 20 cm

**Teknikë mikse dhe kolazh druri në
pëlhurë / Mixed technique and wood
collage on canvas**










only you







BALL'

KAN

Kush është politika e ballkanit?

Si funksionon?

Simetri ngjarjesh kërkesash dhe fenomenesh, personalitete që tregojnë histori si një tregim i paqartë duke bërë spekulime enigmatike me thonjeza dhe kllapa duke kaluar të gjithë parametrat e vlefshme.

Kufijtë territoret, politikat ?

Negociata, dialogje “miqësore”, arsyetime. Jo zgjidhje.

Në dukje formale në thelb mosmarreveshje në shekuj pa sukses.

Paketa formulash sugjerimesh nga fuqitë e mëdha përsëri pa zgjidhje .konflikti vazhdon Rastësi e përkohshme!?

Histori e njëjtë në mënyrë lineare.

Deri kur?

BALL'

KAN

What is Balkan's policy?

How does it work?

Symmetry of events, requests and phenomena, personalities telling an event as a blurry story making enigmatic speculations with parentheses and inverted commas crossing all valid parameters.

Borders, territories, politics?

Negotiations, “friendly dialogs”, excuses. No solutions...

Formal in appearance, disagreements through centuries with no successes

Packages of formulas, suggestions from greater powers, yet with no solutions, conflict continues.

Temporary chance!?

Same ongoing story

Till when?

Video Art

Majlinda Kelmendi




A është e shkuara ëndërr? /**Is the Past a Dream?****2017**

420 cm x 210 cm

Akril në pëlhurë / Acrylic on canvas







A është e shkuara ëndërr? /

Is the Past a Dream?

2017

210 cm x 210 cm

Akril në pëlhurë / Acrylic on canvas



A është e shkuara ëndërr? /

Is the Past a Dream?

2017

210 cm x 210 cm

Akril në pëlhurë / Acrylic on canvas





A është e shkuara ëndërr? /

Is the Past a Dream?

2016

3 X 100 x 210 cm

Akril në pëlhurë / Acrylic on canvas









A është e shkuara ëndërr? /

Is the Past a Dream?


2019

100 cm x 100 cm

Akril në pëlhurë / Acrylic on canvas







A është e shkuara ëndërr? /

Is the Past a Dream?

2018

210 cm x 210 cm

Akril në pëlhurë / Acrylic on canvas







www.info.com

Memoria jonë është aq e fuqishme, sa që ka miliarda informacione të ruajtura në arkivat e saj.

Por, a na kujtohen ne të gjitha kur na duhen?

Apo, atyre i ikën vlera e nuk kujtohen më kurrë?

Njerëzit janë të lidhur ngusht pas informacionit. Nëse njerëzit nuk i kanë informacionet, si do të zhvilloheshin? Kur dhe Gjenet janë pako me informacione. Të gjitha qelizat funksionojnë në bazë të vetë informacionit si një projektim inteligjent i ADN-së.

Si po i përdorim ne këto informacione?

Përderisa çdo ditë ne marrim informacione për zhvillim, avancim, përpunim, argëtim, pse më shumë se gjysma harrohet? Mos ne nuk jemi shumë të përkushtuar pas çdo informacioni? Ndoshta një pjesë e tyre nuk janë shumë të vlefshme, apo mbase e vejmë në dyshim vërtetësinë e tyre?

www.info.com

Our memory is so powerful and it has trillions of information stored in its archives.

However, do we recall them all when we need to?

Or their value is lost and nobody ever remembers them?

People are closely related to the information. How would people develop and progress if they didn't have the information? Even the genes are packages of information. All the cells function according to the information intelligently projected by the DNA.

How are we using this information?

While each day we learn information about the progress, advancement, arrangement and entertainment, why more than half of it is forgotten? Does it mean that we are not committed to every information? Maybe a part of it is not so valuable, or we question their authenticity?

Instalacion / Installation



Majlinda Kelmendi

MAJLINDA KELMENDI (e lindur më 4 tetor 1966, në Tiranë, Shqipëri) është artiste vizuale e njohur me veprimtarinë e saj mbresëlënëse. Ka ekspozuar në muzeun MLAC në Itali, në Austri, Gjermani, Hungari, Portugali, Belgjikë, Spanjë, Poloni, Austri, Texas (SHBA), Çeki, Bullgari, Mal të zi, etj. Pranoi çmime dhe vlerësime në Itali, Belgjikë, Kosovë, Shqipëri etj. Është themeluese e Institucionit artistik “Expo.40” dhe qysh prej 2008 është drejtor artistik i projektit multimedial ndërkombëtar tradicional “Net-Rrjet” (2008 -2018) me artistë vendor dhe ndërkombëtar. Gjithashtu ka realizuar projekte të tjera në rajon e më gjerë. Studimet Universitare kreu në Akademinë e Arteve të Bukura, Tiranë, Shqipëri (1986-1990). Mori titullin Magjistre e Artit nga Fakulteti i Arteve në Universitetin e Prishtinës (1999-2000). Ligjëron në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës, në departamentin e Artit Konceptual dhe Medieve të Reja, prej vitit 2000, ku aktualisht mban titullin Profesor Ordinar.

Niveli i Arsimit: Akademia e Arteve të Bukura, Tiranë, Shqipëri

1) Data e studimit: 1986-1990.

Lloji i edukimit: Edukimi i Lartë 4 vjeçar

2) Institucioni: Ka marrë titullin Magjistrere e Pikturës në Akademinë e Arteve të Bukura në Prishtinë

Data e studimit: 1999-2000

Lloji i arsimit: Edukimi i Lartë 2 vjeçar

3) Diplomë Akademike: Profesor Ordinar

Institucioni: Fakulteti i Arteve të Bukura, Universiteti i Prishtinës

Data e diplomës: 2000 – present.

SOLO - EKSPOZITA

2019- A është e shkuara ëndërr?

Galeria Kombëtare e Kosovës

2019- COESTISTENZA - MLAC, Museo -Laboratorio di Arte Contemporanea



Sapienza Università di Roma, Italia

2018- Lidhja me origjinën - Galeri Domus Romana, Romë, Itali

2017- Identiteti "Ora e Maleve, Nacional Galeri, Mali i Zi.

2017- Poetike Kalimera. Ulqin, Mali i Zi

2017- Galeria Kombëtare e Arteve Sarandë. Shqipëri

2016- Lidhja me origjinën -Gebietsbetreuung10,
Quellenstrasse. Vjenë, Austri.

2016- Galeria B / Bocholt, Gjermani.

2013- Plein- Art Festivali i Artit Bashkëkohor
Budapest Erlin Gallery

2013 -Galeria Kombëtare e Arteve ChifteAmam. Shkup,
Maqedoni.

2012- "E bardha ne te Bardhe "FAP / Galeria e Arteve,
Universiteti Atrvr/Tiranë. Albania.

2012- Galeria Kombëtare e Arteve. Shkodër, Shqipëri.

2011- Video / Art / Performancë - Dialogu i Ballkanit.
Galeria Expoart.40. Prishtinë, Kosovë.

2008- Identiteti, Galeria Expoart.40 Prishtinë, Kosovë.

2008- Galeria Art Oldrado da Ponte, Lodi, Itali.
 2005- Galeria e Ministrisë së Kulturës, Prishtinë, Kosovë.
 2003- Galeria e Artit Bari, Itali.
 1997- Galeria e Arteve, Tiranë, Shqipëri.

EKSPOZITA KOLEKTIVE

2019- Këlni në Rajnë: Qendra Kulturore Këln-Mühlheim, 17 prill
 - 28 prill 2019 (ekspozita kryesore me shfaqje private, çmime
 dhe program kulturor) Germany.
 2019- Boni në Rajnë: Biblioteka e Qytetit Bon- Bad Godes-
 berg, 2 maj - 27 qershor 2019 Germany.
 2019- Nassau në lumin Lahn: (për Nassau, Këln dhe Bon).
 Muzeu (Günter-Leifheit-House), 12 mars - 12 prill 2019
 Germany.
 2018- Koborn - Gondorf në lumin Mosellë: Komunë, 1
 9 nëntor - 7 dhjetor 2018 Germany.
 2018- Bad Breisig në lumin Rajnë: "Kulturbahnhof"
 Qendra e kulturës, 18 gusht - 29 gusht Germany.
 2018- Artexpo Summer Romë 2018, Ekspozita
 Ndërkombëtare e Artit në Romë (Itali), në Galerinë Domus
 Romana, Via Quattro Fontane, Romë Italy
 2017- Skenografi, Majlinda Kelmendi, Monodramë
 "Portreti i Papërfunduar",
 2017- Ekspozitë Galeria e Fakultetit të Arteve të Bukura
 Universiteti Prishtinës
 2017- Diaspora 2017 Kunsthaus, Galerie B, Bocholt. Germany.
 2016- Global KOSOVA ART'6 Arte Globale
 2015- Ekspozitë Galeri Fakulteti i Arteve të Bukura Universi-
 teti Prishtinë
 2014- Ekspozitë në Muzeun e Kosovës, Prishtinë
 2014- German International Kunstausstellung "Expo Diaspora"
 në Bocholt Muzeu Germany.
 2013- Galeria e Fakultetit të Arteve të Bukura Universiteti i

Prishtinës “40 vjet art”

2013- Galeria “B” Gjermani “Arti i diasporës”

2013- Galeria “Qahili”

2012- Identitetet e fshehura dhe të ndaluara “Ekspozita Ndërkombëtare e Artit, Festivali i video Arteve. Venedik, Itali

2011- Ekspozita e Nëntorit në Muzeun e Kosovës, Prishtinë, Kosovë, SHAFK

2011 - Ekspozitë në Muzeun e Kosovës, Prishtinë, Kosovë, SHAFK

2011- Ekspozita e SHAFK (Shoqata e Artistëve Figurativë të Kosovës)

2011- Një mënyrë - Vieira Portugal, Galeri, Porto, Portugali

2011- Muzeu i Lamego, Portugali

2011- Red Gate Gallery - Londër, Mbretëria e Bashkuar

2011- Ekspozita e 8-të Ndërkombëtare “Çmimi Muslim Mulliqi 2010”, Galeria e Arteve të Kosovës, Prishtinë,

2011 - Ekspozita e Artit Shqiptar në Bydgoszcz “Kopshti i Ëndrrave”, Galeria Miejskiej, Krakov, Poloni

2010- Ekspozita Net /Rrjet Edition II, Galeria Expoart.40, Prishtinë, Kosovë

2010- Ekspozitë e Profesorëve të Universitetit, Galeria Expoart.40, Prishtinë, Kosovë

2010- Galeria Atlantica, Muzeu / Portalegre, Portugali

2010- Ekspozitë në Galerinë Financiero de Vigo, Spanjë

2010- Dasma e bardhë, Belgjikë

2010- Dasma e bardhë, Prishtinë, Kosovë

2010- Ekspozita Nënë Tereza, Shkup, Maqedoni

2009- Ekspozita Net -Rrjet Edicioni 1-rë, Galeria Expoart.40, Prishtinë, Kosovë

2009 - Nëntor 2009 Ekspozitë, Maqedoni

2009 - Ekspozita e Artistëve Kosovarë, Muzeu i Artit Schaerbeek / Bruksel, Belgjikë

2009 - Muzeu i Artit, Portugali.

2009 - Bialja e Vizatimeve, Kosovë

- 2008 – Premio Merliani 137, Edizioni 2-të Napoli, Itali
- 2008- Ekspozitë në galerinë e arteve, Gjilan, Kosovë
- 2008 - Galeria Kledio, Tiranë, Shqipëri
- 2008 - Galleria Oldrado da Ponte. Lodi, Itali, Mostra collettiva 'Arte Contemporanea)
- 2008 – Ekspozita 11 Qershori Dita e Prishtinës, Prishtinë, Kosovë
- 2008 - Ekspozita "Amerikan bienale" Austin, Teksas, SHBA
- 2008 - Trofeo di Capodanno, Beinasco, Itali
- 2008 - Bialnja e grafikës së vogël, Breslav, Republika Çeke
- 2008 - Ekspozitë me 20 artistë. Galeria e Arteve, Prishtinë, Kosovë
- 2008 - 7 vjetori i botimit të artit botëror-Mini, Lessedra, Bullgari
- 2008 - Ekspozitë në Galerinë e Arteve, Gjilan, Kosovë
- 2008 - Ekspozitë në Galerinë e Arteve, Pejë, Kosovë
- 2008 - Bialnja e 11-të Vizatimeve, Galeria e Arteve, Prishtinë, Kosovë
- 2008 – Academie Europeenne des Arts, Gembloux, Belgjikë
- 2008 - Ekspozitë e përbashkët, Luksemburg
- 2008- Ekspozitë në galerinë e Arteve, Gjilan, Kosovë
- 2008 - Ekspozita e SHAFK, Galeria e Arteve, Prishtinë, Kosovë
- 2008 - Galeria e Artit, Shkodër, Shqipëri
- 2008 - Salloni i Nëntorit, Galeria e Artit, Prishtinë, Kosovë
- 2008- Ekspozita Nëntor 2008, Galeria e Artit, Tiranë, Shqipëri
- 2008- Panairi i Artit Bashkëkohor, Milano-Novegro, Itali
- 2008- Vendas Novas e 14-të ndërkombëtare, Portugali
- 2008 - Galeria Atlántico e 14-të Ndërkombëtare e Vendasit, Portugali
- 2008- Projekti S. Barbara - Quarta Cava d'Estrazione d'arte, Iglesias, Itali
- 2008- Venti Perventi, Napoli, Itali
- 2007- Ekspozitë e organizuar në ambientet e Geverisë, Prishtinë, Kosovë

- 2007- Ekspozita e Nëntorit. Draudakum, Shkup, Maqedoni.
- 2007- Ekspozita e Artit Bashkëkohor, Galeria e Artit, Tiranë, Shqipëri
- 2007- Bialja e IV e ndërkombëtare e grafikës, Shkup, Maqedoni
- 2007- Ekspozita e Shoqatës së Artistëve, Muzeu i Historisë, Prishtinë, Kosovë
- 2007- Ekspozitë me 10 artistë, Galeria e Arteve, Prishtinë, Kosovë
- 2007- Bialja e Artit të Vogël Grafik, Breslau, Republika Çeke
- 2007- Salloni i Nëntorit, Galeria e Arteve, Prishtinë, Kosovë
- 2007- Galeria e 8-të Ndërkombëtare e Arti Bashkëkohor, Lessedra, Bullgari
- 2006- Ekspozitë me pesë artistë, Paris, Francë
- 2006- Ekspozita e 4-të Ndërkombëtare “Çmimi Muslim Mulliqi”, Galeria e Arteve, Prishtinë, Kosovë
- 2006- Salloni i Nëntorit, Galeria e Arteve, Prishtinë, Kosovë
- 2006- Salloni i 36-të, Akademia e Arteve Evropiane, Gembloux, Belgjikë
- 2006- Ekspozita e Qershorit, Prishtinë, Kosovë
- 2005- Ekspozita e dedikuar 8 Marsit, Muzeu i Kosovës, Prishtinë, Kosovë
- 2005- Dita e Prishtinës, 12 qershor, Prishtinë, Kosovë
- 2005- Ekspozitë për 30 vjetorin e Fakultetit të Arteve, Universiteti Prishtinës, Kosovë
- 2004- Bialja Ndërkombëtare e Vizatimit, Galeria e Arteve, Prishtinë, Kosovë
- 2004- Dita e Prishtinës, 11 qershor, Prishtinë, Kosovë
- 2003- 10 qershor, Ekspozitë, Galeria e Arteve, Prishtinë, Kosovë
- 2002 - 9 qershor Ekspozita, Galeria e Arteve, Prishtinë, Kosovë
- 2002- Ekspozita më 8 mars, Teatri Kombëtar, Prishtinë, Kosovë
- 2001- Ekspozita e Qershorit, Dita e Prishtinës, Prishtina,

Kosovë

2000 - Galeria Kombëtare e Arteve, Tiranë, Shqipëri

2000 - 11 Bialja e Vizatimeve, Galeria e Arteve, Prishtinë, Kosovë

2000- 27 Nëntor Salon, Galeria e Arteve, Prishtinë, Kosovë

1998- Galeria Kombëtare e Arteve, Tiranë, Shqipëri

1997- Ekspozita Nëntori në Muzeun e Historik Tiranë, Shqipëri

1996- Arte të Aplikuara, Galeria Kombëtare e Arteve, Tiranë, Shqipëri

1995- Galeria Kombëtare e Arteve, Tiranë, Shqipëri

1994- Galeria TE & GI, Tiranë, Shqipëri

1993- Galeria Kombëtare e Arteve, Tiranë, Shqipëri

1992- Galeria Kombëtare e Arteve, Tiranë, Shqipëri

Projektet e Përfunduara

2017- Net- Network-Edicioni 10-të Koncepti kuratorial:

“Please prove you are not a robot!”

2016- Net- Network-Edicioni 9-të Koncepti: Koncepti

kuratorial: “Question Off the Day”

2015- Net- Network-Edicioni 8-të: Koncepti kuratorial:

“Denied”

2015- Net- Network- Edicioni 7-të Tiranë Shqipëri Koncept:

“Restart”

2015- Net- Network- Edicioni 7-të Prishtinë Koncepti:

Koncepti kuratorial: “Restart”

2014- Net- Network- Edicioni 6-të Koncepti:

Koncepti kuratorial: “Save As”

2013- Net- Network- Edicioni 5-të Koncepti:”

Trans-Net / Ethno-Ethics”

2012 - Net-Network- Edicioni 4-të Koncepti: “Fighting Human

Trafficking Through Art”

2011 - Net-Network-Edicioni 3-të Koncepti:

“Balkans Dialogue”

2010 - Net-Network-Edicioni 2-të Koncepti: “Media Art - Art media = social power”

2009 - Net-Network-Edicioni 1-rë Koncepti: “Social Technology”

2009 - Reflection /Edicioni 1-rë

2010 - Reflection / Edicioni 2-të

2010 - Born for This

2010 - Europe – Europe.

2006 - A Road with No End.

2005 – My Population and Anther.

Çmimet dhe Anëtarësimet:

2008 - Çmimi i Parë në Galerinë e Arteve, Pejë, Kosovë

2008 - Çmimi i Parë, Ekspozita Mars 2008, Kosovë

2008 - Çmimi i Parë, Ekspozita për Ditën e Prishtinës, Prishtinë, Kosovë

2008 - Medalja e Bronzit, në sallonin e 38-të të konkursit ndërkombëtar, Belgjikë.

2008 - Diploma për Meritë, PremioMerliani 137 2, Napoli, Itali

2006 - U nderua me Medaljen e Artë, Akademia e Arteve Evropiane, Belgjikë

1996 - Çmimi i dytë, Artet e Aplikuara, Shqipëri

Përvoja e punës:

1) Viti: 1990-2000

Emri i Institucionit: Liceu Artistik Tiranë

Pozita: Profesor

Lenda: Pikturë

Vendi: Tiranë / Shqipëri

2) Viti: 2000 - Tani

Emri i Institucionit: Fakulteti i Arteve, Universiteti i Prishtines.

Përshkrimi i titullit: Profesor Ordinar

Lënda: "Piktur dhe Nudo"

Katedra e Artit Konceptual dhe mediat e Reja

Vendi: Prishtinë, Kosovë

3) Viti: 2008 - Tani

Emri i Institucionit: Galeria: Expoart.40

Përshkrimi i titullit: Themeluese dhe Drejtoreshë Artistike

Themeluese dhe organizatore e projekteve ndërkombëtare
multimediale.

Vendi: Prishtinë, Kosovë

Viti: 2012-2016

Emri i Institucionit: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe
Teknologjisë.

Përshkrimi i punës: Këshilli shtetëror për licencim.

Përshkrimi: Anëtare

Vendi: Prishtinë, Kosovë

Viti: 2012-2015

Emri i Institucionit: Rektorat- Universiteti i Prishtinës.

Përshkrimi i punës: Komisioni për doktoratura.

Përshkrimi: Anëtare

Vendi: Prishtinë, Kosovë

Majlinda Kelmendi

(EN)MAJLINDA KELMENDI (born October 04, 1966 in Tirana, Albania) is a visual artist, well known for her impressive artwork. She exhibited in MLAC Museum in Italy, in Austria, Germany, Hungary, Portugal, Belgium, Spain, Poland, Austria, Texas (USA), Czech Republic, Bulgaria, Montenegro, etc. She received prizes and reviews in Italy, Belgium, Kosovo, Albania, etc. She is the founder of “Expo.40” and Art Director of the International Multimedia Project “Net-Rrjet” (2008 -2018) with local and international artists. She has implemented several other projects in the region and wider. She graduated from the Academy of Fine Arts in Tirana, Albania (1986-1990). She got her master’s degree from the Arts Faculty in Prishtina (1999-2000). Kelmendi currently teaches in the Department of Conceptual Art and New Media, Faculty of Arts, University of Pristina since 2000, where she holds the title Professor Ordinarius.

PERSONAL EXHIBITIONS

2019 - Is the past a dream? The National Gallery of Kosovo
 2019 – “Coesistenza” MLAC, Museo Laboratorio di Arte Contemporanea Sapienza Università di Roma, Italy
 2018 Link to origin –Domus Romana Art Gallery in Rome, Italy
 2017- Identity “Time of mountains, Montenegro.
 2017- Art Club – Personal -Art exhibition Poetic Kalimera. Ulcinj, Montenegro
 2017- The National Art Gallery Sarande. Albania
 2016- Link to origin - Gebietsbetreuung10, Quellenstrasse. Vienna, Austria.
 2016- Personal - Gallery B /Bocholt, Germany.
 2013- Plein -Art Contemporary Art Festival Budapest Erlin Gallery
 2013- The National Art Gallery Chifte Amam. Skopje, Macedonia.
 2012- FAP/ Art Gallery, Tirana. Albania.

2012 -The National Art Gallery. Shkoder, Albania.
 2011 - Gallery Expoart.40. Video/Art/Performance – Balkans Dialogue. Pristina, Kosovo.
 2008 - Gallery Expoart.40. Identity, Pristina, Kosovo.
 2008 – Gallery Art Oldrado da Ponte, Lodi, Italy.
 2005 - Gallery of Ministry of Culture, Pristina, Kosovo.
 2003 – Gallery of Art Bari, Italy.
 1997 - Art Gallery, Tirana, Albania.

COLLECTIVE EXHIBITIONS

2019- Cologne on the Rhine:Cultural center Cologne-Mühlheim, April 17 – April 28, 2019 (main exhibition with vernissage, awards and cultural program) Germany
 2019- Bonn on the Rhine:City Library Bonn-Bad Godesberg, May 2 – June 27 Germany
 2019- Nassau on the river Lahn: (for Nassau, Cologne and Bonn) Municipal Museum (Günter-Leifheit-House), March 12 – April 12 Germany
 2018- Koblenz-Gondorf on the river Moselle:Town Hall Foyer, November 19 – December 7 Germany
 2018- Bad Breisig on the river Rhine: “Kulturbahnhof” - Cultural center, August 18 – August 29, 2018 (with cultural program) Germany
 2018- Artexpo Summer Rome 2018,International art exhibition in Rome (Italy),from June 16 to July 1,2018, vernissage, at Domus Romana Art Gallery, Via Quattro Fontane, Rome Italy
 2017 – Scenography Majlinda Kelmendi, Monodrama “Unfinished Portrait”,
 2017 Exhibition Gallery Faculty of Fine Arts University Pristina
 2017-Diaspora 2017 Kunsthaus, Galerie B, Bocholt. Germany.
 2016- Global KOSOVA ART- 6 Global Art Contest
 2015- Exhibition Gallery Faculty of Fine Arts

University Pristina

2014- Exhibition at Museum of Kosovo, Pristina

2014-Germany International Kunstaussstellung

“Expo Diaspora” in Bocholt

2013 -Gallery Faculty of Fine Arts University of Pristina

”40 years of Art”

2013 -Gallery” B “Germany “Diaspora art”

2013-Gallery “ Qahili “ White, Kosovo

2012 - Hidden & Forbidden Identities “International Art Expo,
Video Art Festival Venice, Italy

2011 – November Exhibition at Museum of Kosovo, Pristina,
Kosovo, KFAA

2011 - Exhibition at Museum of Kosovo, Pristina, Kosovo,
KFAA

2011 - Exhibition of the KFAA (Kosovo Figurative Artists
Association)

2011 - One Way - Vieira Portugal, Gallery, Porto, Portugal

2011 - Museum of Lamego, Portugal

2011 - Red Gate Gallery – London, United Kingdom

2011 – 8th International Exhibition “Muslim Mulliqi Prize
2010”, Kosovo Art Gallery, Pristina,

2011 - Albanian Art Exhibition in Bydgoszcz “Garden of
Dreams”, Gallery Miejskiej, Krakow, Poland

2010 - Exhibition Net / Net Edition II, Gallery Expoart.40,
Pristina, Kosovo

2010 – Exhibition of University Professors, Gallery
Expoart.40, Pristina, Kosovo

2010 – Galeria Atlantica, Museum 2010 Portalegre, Portugal

2010 - Exhibition at the Gallery Financiero de Vigo, Spain

2010 - White wedding, Belgium

2010 - White wedding, Pristina, Kosovo

2010 - Exhibition Mother Therese, Skopje, Macedonia

2009 - Exhibition Net / Net Edition I, Gallery Expoart.40,
Pristina, Kosovo

2009 - November 2009 Exhibition, Macedonia

- 2009 - Exposition d Artistes Kosovo, Museum of Art Schaerbeek/Brussels, Belgium
- 2009 - Factory, Museum of Art, Portugal.
- 2009 - Biennale of Drawings, Kosovo
- 2008 - Premio Merliani 137 2° edizione, Naples Italy
- 2008 - Exhibition Gallery of Arts, Gjilan, Kosovo
- 2008 - Gallery Kledio, Tirana, Albania
- 2008 - Galleria Oldrado da Ponte. Lodi, Italy, (Description: Mostra collettiva d'Arte Contemporanea)
- 2008 - Exhibition on 11th June Pristina's Day, Pristina, Kosovo
- 2008 - The American Biennial Exhibition, Austin, Texas, USA
- 2008 - Trofeo di Capodanno, Beinasco, Italy
- 2008 - Biennale of Small Graphic, Breslav, Czech Republic
- 2008 - Exhibition with 20 artists. Arts Gallery, Pristina, Kosovo
- 2008 - 7th Lessedra World Art Print Annual-Mini Print, Lessedra, Bulgaria
- 2008 - Exhibition at the Gallery of Arts, Gjilan, Kosovo
- 2008 - Exhibition at the Gallery of Arts, Peja, Kosovo
- 2008 - The 11th Biennial of Drawings, Gallery of Arts, Pristina, Kosovo
- 2008 - Academie Europeenne des Arts, Gembloux, Belgium
- 2008 - An Exhibition organized, Luxemburg
- 2008 - An Exhibition Gallery of Arts, Gjilan, Kosovo
- 2008 - Exhibition of KFAA, Gallery of Arts, Pristina, Kosovo
- 2008 - Gallery of Art, Shkoder, Albania
- 2008 - November Salon, Gallery of Art, Pristina, Kosovo
- 2008 - Exhibition November 2008, Gallery of Art, Tirana, Albania
- 2008 - Fair of Contemporary Art, Milan-Novegro, Italy
- 2008 - 14th International of Vendas Novas, Portugal
- 2008 - Atlántico Gallery and 14th International of Vendas, Portugal
- 2008 - S. Barbara Project - Quarta Cava d'Estrazione d'art, Iglesias, Italy

2008 - ARTE CONTEMPORANEA CITTA' DI PISTOIA, Pistoia City, Italy

2008 - Ventiperventi, Naples, Italy

2007 - Exhibition organized in the premises of Government, Pristina, Kosovo

2007 - Exhibition of November org. Draudakum, Skopje, Macedonia.

2007 - Exhibition of Contemporary Art, Gallery Art, Tirana, Albania

2007 – 4th Biennale of International Graphic, Skopje, Macedonia

2007 – Exhibition of Artists' Association, Museum of History, Pristina, Kosovo

2007 - Exhibition with 10 artists, Arts Gallery, Pristina, Kosovo

2007 - Biennale of Small Graphic Art, Breslav, Czech Republic

2007 – November Salon, Gallery of Arts, Pristina, Kosovo

2007 – 8th International mail, Gallery & Contemporary Art, Lessedra., Bulgaria

2006 – An Exhibition with five artists, Paris, France

2006 - 4th International Exhibition “Muslim Mulliqi Prize”, Gallery of Arts, Pristina, Kosovo

2006 – November Salon, Gallery of Arts, Pristina, Kosovo

2006 – 36th Salon, Academy of European Arts, Gembloux, Belgium

2006 - June's Exhibition, Pristina, Kosovo

2005 - Exhibition dedicated to 8th March, Museum of Kosovo, Pristina, Kosovo

2005 – June 12th Pristina's Day, Pristina, Kosovo

2005 - Exhibition on 30th Anniversary of Art Faculty, Pristina, Kosovo

2004 - International Drawing Biennale, Arts Gallery, Pristina, Kosovo

2004 – June 11th Pristina's Day, Pristina, Kosovo

2003 - June 10 th Exhibition, Gallery of Arts, Pristina, Kosovo

2002 – June 9 th Exhibition, Gallery of Arts, Pristina, Kosovo

2002 – Exhibition on March 8, National Theatre, Pristina, Kosovo
 2001 - June's Exhibition, Pristina's Day, Pristina, Kosovo
 2000 - National Art Gallery, Tirana, Albania
 2000 – 11th Biennale of Drawings, Gallery of Arts, Pristina, Kosovo
 2000 – 27th November Salon, Gallery of Arts, Pristina, Kosovo
 1998 - National Arts Gallery, Tirana, Albania
 1997- Exhibition November at the Museum of History, Tirana, Albania
 1996 – Applied Arts, National Arts Gallery, Tirana, Albania
 1995 - National Arts Gallery, Tirana, Albania
 1994 – The Gallery TE&GI, Tirana, Albania
 1993 - National Arts Gallery, Tirana, Albania
 1992 - National Arts Gallery, Tirana, Albania

Completed Projects

2017-Net- Network-10 Edition Concept: Curatorial concept: Please prove you are not a robot!
 2016- Net- Network-9 Edition Concept: Curatorial concept: Question Off the Day
 2015- Net- Network-8 Edition Concept: Curatorial concept: Denied
 2015- Net- Network-7 Edition Tirana Albania Concept: Restart
 2015- Net- Network-7 Edition Pristina Concept: Curatorial concept: "Restart"
 2014- Net- Network-6 Edition Concept: Curatorial concept: Save As
 2013- Net- Network-5 Edition Concept: Trans-Net / Ethno-Ethics
 2012 - Net- Network-4 Edition Concept: Fighting Human

Trafficking Through Art

2011 - Net- Network-3 Edition Concept: Balkans Dialogue

2010 - Net- Network-2 Edition Concept: Media Art -

Art media = social power

2009 - Net- Network-1 Edition Concept: Social Technology

2009 - Reflection. / 1 Edition

2010 – Reflection / 2 Edition

2010 - Born for This

2010 - Europe – Europe.

2006 - A Road with No End.

2005 - My Population and Anther.

Awards and Membership:

2008 - First Prize at the Art Gallery, Peja, Kosovo

2008 - First Prize, Exhibition March 2008, Kosovo

2008 - First Prize, Pristina's Day Exhibition, Pristina, Kosovo

2008 - Bronze Medal, at 38th Salon concourse international, Belgium.

2008 - Diploma of Merit, Premio Merliani 137 2nd, Naples, Italy

2006 – Awarded with Silver Medal, Academy of European Arts, Belgium

1996 - Second Prize, Applied Arts, Albania

Work experience record:

1)Year: 1990-2000

Name of the Institution: School of Arts

Position: Professor

Subject: Painting

Location: Tirana /Albania

2)Year: 2000-Present

Name of the Institution: Faculty of Arts

Job description: Professor

Subject description – Nude & Paintings

Location: Pristina / Kosovo

3)Year: 2008- Present

Name of the Institution: Gallery: Expoart.40

Job description: Founder and Artistic Director

Description: Founder and organizer of art projects at national and international level.

Location: Pristina / Kosovo

Year: 2012-2016

Name of the Institution: Ministry of Education, Science and Technology.

Job description: Council state for licensing.

Description: Member

Location: Pristina / Kosovo

Year: 2012-2015

Name of the Institution: Rectorate of the University of Prishtina.

Job description: Commission for doctorates.

Description: Member

Location: Pristina / Kosovo

(Dacă nu ai încă o nouă păr este oprită și e poroșet, realizează-ți dintr-o dată că)

(Mălina Albramciuc)

*The world does not need an artist who presents the reality,
(Marina Abramovic)*

Il matrimonio degli sposi è seguito da un ricevimento a sala con 150 invitati. La cerimonia è stata celebrata dal sacerdote diocesano di San Giovanni Lupatoto, don Antonio Agostini. Le nozze sono state rese più intime dal fatto che i due sposi, che hanno conosciuto la loro futura sposa durante la loro permanenza all'università, hanno deciso di non invitare i genitori. La festa ha avuto luogo nella sala del castello di San Giovanni Lupatoto, dove il principe ha ricevuto i suoi ospiti. La cerimonia è stata celebrata dal sacerdote diocesano di San Giovanni Lupatoto, don Antonio Agostini. Le nozze sono state rese più intime dal fatto che i due sposi, che hanno conosciuto la loro futura sposa durante la loro permanenza all'università, hanno deciso di non invitare i genitori. La festa ha avuto luogo nella sala del castello di San Giovanni Lupatoto, dove il principe ha ricevuto i suoi ospiti. La cerimonia è stata celebrata dal sacerdote diocesano di San Giovanni Lupatoto, don Antonio Agostini. Le nozze sono state rese più intime dal fatto che i due sposi, che hanno conosciuto la loro futura sposa durante la loro permanenza all'università, hanno deciso di non invitare i genitori. La festa ha avuto luogo nella sala del castello di San Giovanni Lupatoto, dove il principe ha ricevuto i suoi ospiti.

[illegible]

Elliott Caine





